

## KLSH merr pjesë në takimin e organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes

25 shtator 2024

Përfaqësues të KLSH-së morën pjesë në takimin e organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes me temë *“Vlerësimi i performancës dhe progresit: Një rishikim gjithëpërfshirës i rolit të SPAK dhe Gjykatave Speciale në luftën kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar (2020-2023)”*, i cili u zhvillua në ambjentet e Hotel Rogner.



Ky vlerësim, vendosi në fokus përfshirjen e të gjithë aktorëve vendas dhe ndërkombëtarë për të dhënë secili kontributin e tyre për të mbështetur përpjekjet e Shqipërisë në përmbushjen e standarteve të Bashkimit Europian, ku lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është një nga sfidat e saj më përcaktuese.

Po ashtu, në këtë takim u diskutua për rolin dhe kontributin e institucioneve shtetërore dhe atyre publike, organizatave dhe shoqërive civile për të forcuar bashkëpunimin me këto struktura, me qëllim për të bërë një vlerësimin objektiv, kritik , gjithëpërfshirës dhe të pavarur në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.